



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/41
Datë: 23.10.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 9.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2008, mori

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ndërmintor që të analizojë opsionet për participimin e sektorit privat në PTK Sh.A. duke përfshirë edhe privatizimin eventual të të gjitha apo disa njësive të biznesit të PTK Sh.A., në këtë përbërje:
 - 1) Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave, kryesues
 - 2) Lutfi Zharku, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë
 - 3) Fatmir Limaj, Ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit
 - 4) Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale
 - 5) Sadri Ferati, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal
2. Komisioni do t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës opsionet e mundshme (privatizimin eventual) të PTK Sh.A.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë